



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Qershor 2024

Data 26.06.2024 ora 15:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

1. Projekt vendim për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës Znj.Majlinda Zef Ndreca.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2024.
- 3.Projekt vendim për shprehjen e mendimit në lidhje me ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Shkoder Sh.A.
- 4.Projekt vendim për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, vkb nr.91 datë 21.12.2023, sipas akt marrëveshjes nr.64/1 datë 09.04.2024, ndërmjet Këshillit Qarkut Shkoder dhe Bashkisë Vau Dejës.
- 6.Raport i monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhën Janar-Prill 2024 dhe vetëvlerësimin e gjendjes financiare Janar-Prill 2024.
- 7.Projekt vendim për miratimin e projektit të parë të PBA 2025-2027 për Bashkinë Vau Dejës.
- 8.Projekt vendim për dhënie pelqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurrimit publik, me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.2973 ha, pjese e pasurisë nr.22, Zk 1100, e llojit “kullotë” në fshatin Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës “Për mbarështimin e faunes së egër dhe gjahut”
- 9.Projekt vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave.

10. Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.31 datë 29.04.2024 “Mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga tërmeti i dt.26.11.2019”

11. Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.71 datë 28.09.2023 “Mbi miratimin e objektit Urë Pasarelë me hapësirë drite HD 80ml në fshatin Mnelë e vogël”.

12. Të ndryshme.

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Qershor 2024, u zhvillua me datë 26.06.2024 ora 15.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija. Të pranishëm në sallë ishin 21 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 20 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës Znj.Majlinda Zef Ndreca.

Z. Ervis Shimaj realaton për këshilltarët se bazuar në vendimin nr.47 datë 16.05.2024 të KQZ Tiranë për plotesimin e vakances në Këshillin Bashkiak Vau Dejes, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë Znj.Majlinda Zef Ndreca si pasojë e dorëheqjes nga anëtarë i këshillit Z.Afrim Kapidanja, si dhe në propozimin e komisionit të mandateve, ju propozoj miratimin e mandatit si anëtare e këshillit bashkiak Vau Dejës për Znj.Majlinda Ndreca.

Hidhet në votim propozimi: Miratohet me 20 vota Pro.(Znj. Majlinda Ndreca pa të drejt vote)

Z.Ervis Shimaj fton Znj. Majlinda Ndreca për të bërë betimin, e cila betohet pas leximit të formules së betimit.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Maj 2024, te perfitojne 142 familje, me 480.892 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkinë Vau Dejës, për muajin Maj 2024 janë shpallur fitues, 1.036 familje, me fond 8.014.892 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 480.534 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 21vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për shprehjen e mendimit në lidhje me ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Shkoder Sh.A.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar përfaqesuesen e shoqërisë rajonale ujesjelles kanalizimeve Shkodër Sh.a, Znj. Edona Kraja e cila relaton për këshilltarët se kemi realizuar një dëgjese publike me banorët e Bashkisë Vau Dejs ku kemi paraqitur një analizë financiare të shoqërisë tonë dhe arsyet e rritjes së çmimeve dhe tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura dhe sipas analizave që kemi bërë kemi arritur në përfundimin se duhet te rritet çmimi. Aktualisht shpenzimet e shoqërisë, mbulphen ne nivele të ulëta nga të ardhurat dhe e kemi parë të nevojshme se duhet të ofrohet shërbim cilesor dhe duke mbuluar nje pjese më të madhe të territorit të Bashkisë Vau Dejës. Lidhur me rritjen e tarifave dhe çmimeve për familjarët dhe për bizneset ju kemi sjellë tabelat perkatëse.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur dhe diskutuar.

Z.Frano Prenga-Kryetar i komisionit te shërbimeve publike, transportit, lëvizshmërisë mjedisore, parqeve dhe rekreacionit, parkingjeve. Shprehet se ne si komision kemi propozuar mos dhënien e pëlqimit në lidhje me ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Shkoder Sh.A, sepse kemi konstatuar se nuk ka fakte dhe argumenta të plota për këtë qëllim.

Z.Ervis shimaj pyet: Cilat janë konkluzionet e dëgjesës publike që keni realizuar?

Znj Edona Kraja pergjigjet: Askush nuk ka deshire rritje tarifash dhe çmimesh, për me rritë cilësinë e shërbimit, duhet me rrit tarifat.

Z.Ermir Tahiri- këshilltarë, pyet:Me çfarë cilësie po na shërbeni se p.sh në fshatin Kosmaç, nuk funksionon ujësjellësi, par a jeni në gjendje te na përgjigjeni se sa perqind shërbehet ne fshatrat e Bashkisë?

(Nuk merr përgjigje për sa pyet)

Z.Gjon Marku-këshilltarë:Faktet per rritjen e çmimit, nuk na duken bindëse, mendoj se duhet bere nje dëgjese publike e gjerë, me gjithë grupet e interesit.

Kryetari i degës teknike të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Shkoder Sh.A, sqaron se ndërmarrja është duke shërbyer dhe prodhuar ujë mbi kosto, në prodhojmë shumë dhe mblidhen të ardhura pak. Është e nevojshme rritja e investimeve prandaj kerkohet kjo rritje tarifash.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin e paraqitur:

Vota Pro (zero). Vota kundër 21, Vota abstenim (zero). **Nuk Miratohet.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Vau Dejës

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Melita Vjerdha- përgjegjese zyres arsimit pranë Bashkisë Vau Dejës, e cila relatton për këshilltarët se qëllimi kryesor i këtij projekti ishte përmirësimi cilësor i arsimit parashkollor në Bashkinë Vau Dejes duke përfshirë përmirësimin e infrastruktures së kopshteve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor, plan i cili synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent duke përfshirë bashkëpunimin prinder-komunitet. Plani shtrihet në të gjitha kopshtet e Bashkisë Vau Dejës për një periudhë 3 vjeçare.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur dhe diskutuar.

Znj.Rregjina Shelqetja pyet: Çfarë është bërë për fëmijet me aftësi ndryshe të cilët janë në arsimin parashkollor?

Znj.Melita Vjerdha përgjigjet: Aktualisht ky shërbim jepet në disa kopshte por në vazhdimësi do të ketë një plan për rritjen e shërbimit ndaj tyre.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin e paraqitur: Në votim marrin pjesë 19 këshilltarë (Z.Marin Dodaj dhe Z.Kastriot Shkaj nuk marrin pjesë në votim). **Miratohet me 19 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, vkb nr.91 datë 21.12.2023, sipas akt marrëveshjes nr.64/1 datë 09.04.2024, ndërmjet Këshillit Qarkut Shkoder dhe Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën për të relatuar Z.Renado Dodaj-përgjegjës i zyres finance buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili relatton për këshilltarët se qëllimi i projekt vendimit është shtesa në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024, i miratuar me VKB nr.91 datë 21.12.2023, vlerën prej 30.500.000lek e miratuar nga Këshilli Qarkut Shkoder me vendim nr.5/2024 dhe Akt Marrëveshjes nr.64/1 datë 09.04.2024 për bashkëpunimin ndërvendorë në fushën e shërbimeve

publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i rruges Trush i Poshtëm”, ndërmjet Bashkisë Vau Dejës dhe Këshillit Qarkut Shkodër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur dhe diskutuar.

Z.Gjon Marku pyet: Si është perqindja e bashkefinancimit?

Z.Renado Doda pergjigjet: 60% te investimit e realizon Këshilli i Qarkut ndersa 40% e realizon Bashkia me te ardhurat e veta.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin e paraqitur: Në votim marrin pjesë 20 këshilltarë (Z.Marin Dodaj largohet nga mbledhja) . **Miratohet me 20 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Raport i monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhen Janar-Prill 2024 dhe vetëvlerësimin e gjendjes financiare Janar-Prill 2024.

Z.Ervis Shimaj i jep fjelen per te relatuar Z.Renado Dodaj-pergjegjes i zyres finance buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili relaton per keshilltarët lidhur me raportin e monitorimit te buxhetit te Bashkise per periudhen 4 mujore te vitit 2024 si dhe vetevleresimin e gjendjes financiare per 4 mujorin e vitit 2024.Këshilltarët nuk kishin diskutime rreth kesaj pike te rendit te dites dhe bëhet miratimi ne parim me 20 vota pro.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e projektit të parë të PBA 2025-2027 për Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj i jep fjelen per te relatuar Z.Renado Dodaj-pergjegjes i zyres finance buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili relaton per keshilltarët lidhur me projekt vendimin.Z.Doda spjeron te ardhurat dhe shpenzimet që parashikohen te realizohen per periudhen 2025-2027, dhe sqaron se brenda vitit që jemi duhet të diskutojme 3 faza PBA-ne, dhe kjo që ju kemi paraqitur është faza e parë.Në materialin që ju kemi pajisur keni te spjeguar me hollësi dhe detaje të gjitha tarifat, te ardhurat dhe shpenzimet qe parashikohet te zbatohen gjate kesaj periudhe, gjithashtu keni te detajuar edhe peshen specifike për çdo njësi parashikimin e realizimit të të ardhurave.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur dhe diskutuar.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin e paraqitur: Në votim marrin pjesë 20 këshilltarë. **Miratohet me 19 vota Pro, 1 (një) votë kundër(Z.Gjon Marku)**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënie pelqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurrimit publik, me afat deri në 10 vjet, te siperfaqës prej 0.2973 ha, pjese e pasurisë nr.22, Zk 1100, e llojit “kullotë” në fshatin Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës “Për mbarështimin e faunes së egër dhe gjahut”

Z.Ervis Shimaj i jep fjelen per te relatuar Z Ndoc Baqli- pergjegjes i zyres aseteve Bashkia Vau Dejes, i cili relacion per keshilltarët se ky projekt vendim është futur per shqyrtim edhe një herë në këshill por është votuar kundra sepse ka pasë konflikt me banorët e fshatit Barbullush per arsye se prona e kerkuar më parë binte ndesh me ish vorrezat e komunitetit mysliman te ketij fshati.Projekt vendimi qe kemi paraqitur është spostuar sipërfaqe konfliktuale, dhe relativisht edhe është zvogeluar, prandaj kerkojme miratimin nga ana juaj.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur dhe diskutuar.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin e paraqitur: Në votim marrin pjesë 20 këshilltarë.

Miratohet me 20 vota Pro.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e vleres maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave.

Z.Ervis Shimaj i jep fjelen per te relatuar Z.Edmond Gjeçaj-specialist i zyres se strehimit i cili spjeron se lidhur me projekt vendimin e paraqitur,është mbajtur parasysh perparësia qe duhet te mbahet ne subvencionimin e qirase,sipas ketegorigve te percaktuara per strehimin social.Gjithashtu është e specifikuar edhe formula e pergjithshme te llogaritjes se vleres se subvencionit te qirasë, si dhe me afatin e dhenies se qirasë.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur dhe diskutuar.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin e paraqitur: Në votim marrin pjesë 20 këshilltarë.

Miratohet me 20 vota Pro.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.31 datë 29.04.2024 “Mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga tërmeti i dt.26.11.2019”

Z.Ervis Shimaj i jep fjelen per te relatuar Znj. Valjeta Nikaj- pergjegjese e zyres emergjencave civile, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.31 dt.29.04.2024 “Mbi dhëniën e ndihmës financiare të menjëhershme 9(nëntë) familjeve të dëmtuara nga tërmeti i dt.26.11.2029 janë bërë gabime materiale në tabelën që i bashkëngjitet aktit administrativ konkretisht për familjen e Z.Anton Pylla, nga ku diferenca per tu trajtuar ishte 263.789 lek dhe duhet të bëhet 288.789 lek.Kjo është arsyeja që paraqesim projekt vendimi për ndryshimet në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

gabimet materiale të bëra. Ne projekt vendimin e paraqitur janë të detajuara ndryshimet që i duhen bërë aktit administrativ .

Burimi i financimit për diferencën do të jetë fondi i planifikuar në programin “Mbrojtja Civile “në Buxhetin e Bashkisë 2024 i cili është miratuar në VKB Nr.91 dt.21.12.2023 i konfirmuar nga Prefektura me shkresën 2/1 dt.09.01.2024.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur dhe diskutuar.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin e paraqitur: Në votim marrin pjesë 19 këshilltarë.

Miratohet me 19 vota Pro.(Z.Gjon Marku nuk merr pjesë në votim)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.71 datë 28.09.2023 “Mbi miratimin e objektit Urë Pasarelë me hapësirë drite HD 80ml në fshatin Mnelë e vogël”.

Z.Ervis Shimaj i jep fjelen për te relatuar Znj. Valjeta Nikaj- përgjegjese e zyrës emergjencave civile, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit, duke ndërhyrë që të ndryshohet VKB nr 71/2023, për arsye se kanë ndryshuar çmimet e references nga Enti Kombëtar i Banesave sipas VKM nr.126 datë 13.04.2023 dhe referuar kesaj VKM-je rezulton se duhet te ndryshohet vlere e preventivit nga 2.491.106 lek, në vleren 2.847.585 lek, vlerë e cila është çelur në degen e thesarit.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur dhe diskutuar.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin e paraqitur: Në votim marrin pjesë 20 këshilltarë.

Miratohet me 20 vota Pro.

Z.Ervis Shimaj kalon te pika dymbëdhjetë:

Të ndryshme.

Z.Ermir Tahiri ngre shqetesimin se në fshatin Kosmaç, është bërë një nderhyrje në një rrugë në anësore të sajë të fshatit nga një subjekt, dhe kërkoj që të kontrollohet si rast dhe të bëhet rehabilitimi i rrugës.

Znj.Meliha Zyberaj ngre shqetesimin se në lagjen pallate, në qytet, duhet te pastrohen nga barërat e këqija rrugët e kësaj lagje.

Znj.Franga Kola-këshilltare: kërkon që të ndryshohet rregullorja e brendshme e këshillit për rastet kur këshilltarët mungojnë pa arsye në mbledhjet e këshillit duke ju hequr një përqindje të shpërblimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës e datës 26.06.2024 deklarohet e mbyllur nga kryetari këshillit pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA



Këshilltarët:

Enis Shimaj
Fraun Rexhep
Melita Zefire
Eranda Kole
Onela Heshi
Leonora Prepe
Stajlinola Rame
Alcina Livaoli